



# Produkte & Systeme Lyerje

Udhëzues Teknik



**HROMODHOMI**  
*Bojra & Termoizolim*



Kompania Hromodhomi u themelua në vitin 1988 me seli, në një ambjent me sipërfaqe 200m<sup>2</sup>, në zonën e Martiut, në Selanik. Mundësitë, në fillimet e funksionimit të kompanisë, ishin të vogla, teksa kompania kishte në dispozicion pak makineri dhe paisje dhe angazhonte vetëm 2 të punësuar. Por parimi i saj bazë ishte përqëndrimi i vëmendjes tek cilësia e lartë e produkteve, tek marrëdhëniet perfekte me klientët e saj, si dhe tek krijimi i një emri të besueshëm në treg. Në vazhdim Kompania "H" u zhvillua aq sa në vitin 1992 u instalua tek godinat e saj private, me një sipërfaqe 1000m<sup>2</sup>, në Zonën Industriale të Selanikut. Në 6-mujorin e parë të vitit 2001 kompania u shpërngul sërish, në ambiente të reja, në Z.I.S., në një truall privat, me sipërfaqe 4.000m<sup>2</sup>, me sipërfaqe godine 2.850m<sup>2</sup> dhe me pajisje dhe makineri supermoderne, që sigurojnë:

- Administrim ekologjik të mbetjeve.
- Kushte të shkëlqyera prodhimi.
- Laborator të kontrollit të cilësisë, të teksologjisë më të re.
- Laborator kërkim-zhvillimi.
- Organizim bashkëkohor të magazinës.
- Sisteme të besueshme sigurie (zjarrfikës, zjarrizolues etj.).

### Politika e cilësisë

Kompania ka për qëllim të kënaqë klientin mes cilësisë së përkryer të ngjyrave dhe produkteve, mes korrektësisë në marrëveshje, mes cilësisë dhe konkurrencës në çmime, mes amballazhit të duhur të bojërave dhe porosisë në kohë. Kjo kërkon një ineteresim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim të përonave në drejtim dhe të punëtorëve, për përzgjedhjen e duhur, të lëndëve të para dhe produkteve të tregtimit, si dhe përzgjedhjen e distributorëve të duhur dhe të të gjithë bashkëpunëtorëve, për të arritur kërkesat e çertifikimit **ISO 9001:2008**.

Laboratorët e kërkimit, zhvillimit dhe kontrollit të cilësisë së produkteve, disponojnë mjete të teknologjisë së fundit dhe ndjekin për kontrollin, shembujt grekë dhe ndërkombëtarë. Të gjitha produktet e prodhuara mund të kenë çertifikatën e patentës së kontrollit të materialit. Zbatimi i parimeve të cilësisë dhe ruajtja e procedurave të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë që aplikon kompania, sigurojnë cilësinë e lartë dhe konstante, të produkteve të saj, si dhe të shërbimeve që ajo ofron.

### Politika Mjedisore

Kompania jonë kujdeset në mënyrë të vazhdueshme që veprimtaritë e saj prodhuese të kenë ndikime sa më të vogla në mjedis. Në këtë kuadër ka zhvilluar Sistemin e Menaxhimit Mjedisor sipas modelit ISO 14001:2004, i cili përballet me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin.

Në kërkim të përmirësimit të vazhdueshëm të efektit të saj në çështjet mjedisore, kompania përcakton dhe rishqyrton në mënyrë periodike objektiva dhe qëllime mjedisore, duke marrë parasysh:

- legjislacionin për mjedisin,
- anë të rëndësishme mjedisore,
- përzgjedhjet teknologjike,
- objektivat e përgjithshëm të kompanisë,
- mendimet e palëve të interesuara p.sh.: punëtorë, klientë, banorë, organizma etj.,
- mundësitë ekonomike të kompanisë.

Për më shumë, personeli është informuar për kërkesat e sistemit të menaxhimit të mjedisit, për politikën mjedisore, për objektivat parimore, për pasojat e veprimtarive të kompanisë në dhe për mjedisin, si dhe për rastet e mundshme urgjente dhe përballimin e tyre.

Paralelisht, kompania kujdeset për sensibilizimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm të saj, për të minimizuar pasojat negative në mjedis.

Gjithashtu, është pjesë e një sistemi kolegji, të menaxhimit alternativ të ambllazheve (EEAA). Gjithçka e lartpërmendur, në kombinim me përpjekjet aktive dhe të vazhdueshme të të gjithë atyre që përfshihen në proces, sjellin si rezultat përmirësimin e dukshëm të një Sistemi të kompletuar të Menaxhimit Mjedisor.

EN ISO 9001/2008



EN ISO 14001/2004



ÇERTIFIKATA (Foto) EN ISO 9001/2008; EN ISO 14001/2004; EN 13499 EPS; EN 13500 MW; Në të gjithë jetëgjatësinë e kompanisë, aktivitetet e saj karakterizohen nga dinamizmi, kërkimi i vazhdueshëm shkencor dhe aplikimi i metodave pioner në politikat e tregtimit. Dizajnimi, prodhimi dhe disponimi i të gjitha produkteve, si dhe shërbimi ndaj klientit, bëhen të bazuara në sistemin e çertifikimit **ELOT EN ISO 9001**. Besnikë në sa më sipër dhe duke çkoduar elementët dhe tendencat e tregut, orientimi strategjik i kompanisë, sot, i kushton gjithmonë kujdes të veçantë shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, si dhe mbrojtjes së mjedisit.

EN 13499 EPS



EN 13500 MW



Kompania ka zhvilluar sistemin absolut, të kompletuar dhe të çertifikuar, të sistemit të izolimit të jashtëm të godinave të reja dhe të vjetra në **100% ACRYL THERMONOSYSTEM** me polisterol dhe inde pambuku të ngurtë. Për sigurimin e cilësisë së përkryer dhe implementimin e sistemit, është çertifikuar sipas dy tipeve evropiane **ETICS (External Thermal Insulation Composite System)**. Sipas çertifikimeve **EN 13499 EPS me polisterol dhe EN 13500 MW me inde pambuku të ngurtë**. Në këtë formë arrihen kushtet më të mira të izolimit, si për dimrin, ashtu edhe për stinën e verës.

- Boja e çertifikuar plastike **ECO LIFE**, pas kalimit në të, të sistemit ekologjik.
- Produkti **Cover Latex**, si dhe produkti **Cover Acryl**, janë çertifikuar me tipin ELOT 788, sipas provave laboratorike.
- Boja e çertifikuar për vijëzim rrugësh **ROAD PAINT** sipas provave laboratorike.
- Material për tharjen, i çertifikuar, **MONOSTOP**, pas kontrollit laboratorik të ekzemplarëve dhe bazuar në rezultatet e dhëna.

“**HROMODHOMI**” ka për qëllim zhvillimin e saj dhe këtë, po e tregon mes aktivitetit të saj, mes fuqisë së shkëlqyer punëtoare, mes prodhimit të produkteve cilësore, mes investimeve të vazhdueshme në makineri bashkëkohore, mes kualifikimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, duke tejkaluar në mënyrë të përditshme vetveten. D.m.th., për të prodhuar produkte të cilësisë absolute dhe miqësore, për të përmbyshur kështu nevojat dhe kërkesat e konsumatorit bashkëkohor.



<b>P</b>	<b>BOJËRA PLASTIKE   për përdorim të brendshëm</b>	Faq. 6-8
<b>A</b>	<b>BOJËRA AKRELIKE   për përdorim të jashtëm</b>	Faq. 9-11
<b>ITH</b>	<b>IZOLANTË   THARRËS</b>	Faq. 12
<b>NA</b>	<b>NËNSHTRESA   ASTARË</b>	Faq.13-17
<b>LV</b>	<b>BOJËRA LLAKU   BOJËRA VAJI</b>	Σελ.18-19
<b>DG</b>	<b>LLAQE   druri – guri</b>	Faq.20-22
<b>SK</b>	<b>STOKO   KOLLA</b>	Σελ.23-24
<b>I</b>	<b>INDUSTRIALE</b>	Faq.25-26
<b>HV</b>	<b>SHPËRBËRËS (HOLLUES)   VAJRA</b>	Faq. 27
<b>ND</b>	<b>MATERIALE NDERTIMI</b>	Σελ. 27
<b>DE</b>	<b>MATERIALE DEKORATIVE</b>	Faq.28-29
<b>PA</b>	<b>PASTRUES</b>	Faq.30-33
<b>SP</b>	<b>PRODUKTE SPECIALE</b>	Faq. 33
<b>TE</b>	<b>PRODUKTE / TERMOIZOLANTË</b>	Faq.34-37
	<b>PYETJE TË SHPESHTA</b>	Faq. 38

[www.chromodomi.gr](http://www.chromodomi.gr) / [www.thermonosystem.gr](http://www.thermonosystem.gr)

Vizitoni faqet e internetit dhe zgjidhni HROMODHOMI mund të gjeni produktin ose sistemin termoizolues që ju nevojitet.



**Udhëzuesi Teknik i Sistemeve të Bojërave** që mbani në duar është dizenuar për t'u dhënë mundësinë e informimit për çdo produkt veçmas, por edhe për të zgjedhur sistemin e përshtatshëm të lyerjes, sipas kërkesave dhe gjendjes së sipërfaqeve që do të lyeni. Është një udhëzues sinoptik i produkteve kryesore, që mbulojnë të gjithë fazmën, përsa i përket sipërfaqeve për lyerje (murre brenda ose jashtë, sipërfaqe druri apo guri).

### **Si e përzgjedh bojën e duhur?**

Cilësia e rezultatit për çdo punë në **LYERJE DHE MBROJTJE**, varet nga cilësia e produktit që përdorim dhe nga faktorët e tjerë të rëndësishëm, që përcaktojnë rezultatin përfundimtar. Parapërgatitjen e duhur të sipërfaqes para lyerjes, d.m.th. pastrimin e kujdesshëm dhe stokarisjen e saj, si dhe sistemin e lyerjes, d.m.th. kombinimin e duhur, mes nënshtresave dhe produkteve përfundimtare.

### **1. Parapërgatitja e sipërfaqes për lyerje.**

- Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e pastruar nga plasaritje, nga myku, nga substanca vaji etj., si dhe tërësisht e thatë.
- Kur sipërfaqja do të lyhet sërish, duhet pastruar nga pjesë të mufatura dhe duhet të fërkohen ato vende ku boja ka përsuar fryrje dhe është larguar nga nënshtresa e bojës së vjetër.
- Sipërfaqe që janë të sheshta ose të lëmuara, duhen fërkuar me letër zmeril, për të krijuar fërkim dhe për të thyer rrëshqitjen.
- Të gjitha sipërfaqet që do të lyhen, duhet të kalohen me një astar – duke preferuar astarin e rekomanduar për çdo rast.

### **2. Astari**

Rezultati që sjell astari (në mure) është jetëgjatësia e sistemit të bojërave, sepse astari hyn në poret e murit, si dhe shmang fryrjet e sipërfaqes. Kjo arrihet edhe mes hollimit të duhur që i bëhet produktit, në raport me anën poroide të murit (porozitetin).

### **3. Vegla zbatimi (pune)**

- Veglat (ruli, furça) duhet të jenë të pastra dhe të mos jenë të dëmtuara nga përdorimi i tepërt në të shkuarën.
- Përdorni për çdo lloj sipërfaqe, veglën e duhur!

### **4. Hollimi**

- Hollimi i materialeve që do të shtrihen për lyerje, duhet të bëhet sipas udhëzimeve të shkruara në ambllazhin e produktit.

### **5. Kushtet mjedisore të zbatimit**

- Temperatura e mjedisit në të cilët do të zbatohet sistemi i lyerjes, nuk duhet të jetë më poshtë se 5°C dhe jo më shumë se 35°C.
- Shmangni lyrjet, gjatë ditëve me shi dhe kur lagështia e atmosferës është e lartë (mbi 70%).

### **6. Shpërbërës**

Përdorni shërbërësit e sugjeruar, që janë tejet të përputhshëm me bojën, kur bëhet fjalë për lyerje me shpërbërës.

### **7. Magazinimi i bojërave**

- Kutitë që janë hapur dhe mendohet të magazinohen, duhet të mbyllën shumë mirë dhe të vendosen në ambjent me kushte fiziologjike igrasie dhe temperature, për të mbetur të përdorshme në të ardhmen.
- Magazinimi i shpërbërësve ujorë të bojërave që janë holluar me ujë (jo të pijshëm), mund edhe të shkojnë në reaksione biokimike, që mund të shkaktojnë aromë jo të këndshme në ambjent.

### **8. Pastrimi i sipërfaqeve të ndotura**

- Sipërfaqet që janë të lyera me produkte "HROMODHOMI" dhe që janë ndotur, mund të pastrohen lehtësisht me përdorimin e produkteve pastrues që kemi në shtëpitë tona, në doza të lehta.
- Shmangni përdorimin e furçave të ashpra të pastrimit, në mënyrë që të mos traumatizoni filmin e bojës.

**NDIQNI UDHËZIMET E PËRMENDURA NË AMBALLAZHIN E ÇDO PRODUKTI.**



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë plastike pa aromë e cilësisë së përsosur. Kënaq kërkesat e BE-së për avullim të ulët të lidhjeve organike. Ka rezistencë të jashtëzakonshme dhe mbulueshmëri të lartë, për punime cilësore, kjo e bën dhe të famshëm si produkt për profesionistët, dhe jo vetëm. Ideale për mure me suva, për mure të stokarisur, për gipsosanidhë, për dru etj. E domosdoshme për dhomat e fëmijëve, për spitale dhe

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe përdoreni në temperatura mbi 6° celcius dhe më pak se 40° celcius dhe kur igrasia relative është mbi 80%. Kjo bojë mund të shtrohet në dy ose tre duar (shtresa), që duhet të realizohen me një diferencë kohore prej 2 orë nga njëra-tjetra. Produkti përfton të gjithë rezistencën e tij mekanike pas 20-30 ditësh.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
10-15m <sup>2</sup> /lit për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. Përsëritet pas 4-6 orë	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike materiali i parë Astar mbulues



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt , 3Lt, 9Lt, 10Lt



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Termoizolant i cilësisë korife, bojë ideale për termoizolim. Me kokriza speciale qeramike për izolim, termoizolon ambjentin tuaj nga tre format e transmetimit të temperaturës. Njëkohësisht shfrytëzon cilësitë e saj, për të ofruar një ambjent më të ngrohtë dhe më të shëndetshëm, duke ju dhënë mbulueshmëri dhe një sipërfaqe të mëndafshtë. I duron larjeve dhe pastrimeve të shpeshta. Boja termoizoluese **THERMOLIFE** është një novacion i "HROMODHOMI". Është materiali, që sipas matjeve tona ju jep mundësinë deri në 80%, për ngrohje më të shpejtë të ambienteve tuaja, për rrjedhojë bëhet shfrytëzim më i mirë i energjisë që shpenzoni.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pasi pastrojmë sipërfaqen që duam të lyejmë, shtrijmë bojën plastike **THERMOLIFE** të holluar me ujë. Në sipërfaqe metalike sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut).

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
14-20m <sup>2</sup> /lit për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike materiali i parë Astar mbulues



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt , 3Lt, 10Lt



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë plastike e cilësisë korife, bojë për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm. Ofron mbulueshmëri dhe bardhësi. Jep sipërfaqe të mëndafshta dhe hapet përsosmërisht mirë. Punohet lehtë me rul, furçë, ose pistoletë, në sipërfaqe të përgatitura siç duhet. Ka rezistencë të lartë ndaj larjeve të shpeshta.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pastroni sipërfaqen që dëshironi të lyeni, kaloni një dorë bojë plastike STEP të holluar me ujë deri në 15%. Në vazhdim, pas një ose dy orë, kaloni dorën tjetër, duke e holluar 5 deri 10% me ujë. Në sipërfaqe metalike sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut).

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
14-20m <sup>2</sup> /lit për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë, në 10 nuanca dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike materiali i parë Astar mbulues



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt , 3Lt, 9Lt, 10Lt



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë plastike e cilësisë së mirë, për përdorim të brendshëm. Ofron mbulueshmëri të madhe dhe bardhësi. Punohet lehtë me rul, furçë, ose pistoletë në sipërfaqe të pastruara siç duhet.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pastroni sipërfaqen që dëshironi të lyeni. Kaloni një dorë BOLERO të holluar me ujë deri në 15%. Në vazhdim, pas një ose dy orë kalojmë dorën tjetër, duke e holluar 5 deri 10% me ujë. Në sipërfaqe metalike, sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut). Sipërfaqet me hidrokrom, duhet t'i kaloni një herë me astar akrilik të "HROMODHOMI".

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-10m <sup>2</sup> /lit për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike materiali i parë Astar mbulues



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt , 3Lt, 10Lt

COVER LATEX



**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

COVER-LATEX disponon mbulueshmëri të lartë, bardhësi si dëborë dhe rezistencë ndaj larjeve me sfungjer, teksa krijon sipërfaqe të lëmuar. Ofrrohet dhe në nuanca moderne pal. Tejkalon çdo kriter të cilësisë së lartë të bojërave plastike, bazuar tek matjet e ELOT 788.

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pasi ta pastroni mirë sipërfaqen që dëshironi të lyeni, kaloni një dorë COVER\_LATEX të holluar me ujë deri në 15%. Në vazhdim, pas një ose dy orë kaloni dorën tjetër, duke e holluar 5 deri 10% me ujë. Në sipërfaqe metalike sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut). Kushte të papërshtatshme gjatë kyerjes mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësisë së ngjyrës përfundimtare.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-12m2/lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike Materiali i parë



Magazinimi ne kove plastike 0.75Lt\*, 3Lt, 9Lt, 10Lt

NATURA LATEX



**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

Bojë plastike e cilësisë së mirë, për përdorim të brendshëm, me mbulueshmëri të madhe dhe bardhësi përshtypjëlënëse. Përdoret atje ku nuk do të ketë larje të shpeshta të sipërfaqes së lyer.

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pasi ta pastroni mirë sipërfaqen që dëshironi të lyeni, kaloni një dorë COVER-LATEX të holluar me ujë deri në 15%. Në vazhdim, pas një ose dy orë kaloni dorën tjetër, duke e holluar 5 deri 10% me ujë. Në sipërfaqe metalike, sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut). Kushte të papërshtatshme gjatë lyerjes, mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësisë së ngjyrës përfundimtare.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-12m2/lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike Materiali i parë



Magazinimi ne kove plastike 0.75Lt\*, 3Lt, 9Lt, 10Lt

STEP COLOR



**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

Bojë plastike e cilësisë korife, ngjyrë saten, për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm. Ofron mbulueshmëri të madhe dhe bardhësi. Jep një sipërfaqe të mendafshhtë dhe shtrihet përsosmërisht mirë. Punohet lehtësisht me rul, furçë, ose pistoletë në sipërfaqe të pastra. Ka rezistencë ndaj larjeve të shpeshta të sipërfaqes së lyer.

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pasi ta pastroni mirë sipërfaqen që dëshironi të lyeni, kaloni një dorë STEP-COLOR të holluar me ujë deri në 10%. Në vazhdim, pas tre orë kaloni dorën e dytë, duke e holluar deri në 5% me ujë. Në sipërfaqe metalike, sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut). Kushte të papërshtatshme gjatë lyerjes, mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësisë së ngjyrës përfundimtare.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
14-20m2/lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike Materiali i parë



Magazinimi ne kove plastike 0.75Lt\*, 3Lt, 10Lt

UN-MOULD



**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

Bojë plastike kundër mykut UN-MOULD, është një material që zgjidh problemet me mykun në mure. Përbërja e tij e veçantë, me elementë mykoktonë, e bën që të zhdukë indet e mykut të igrasisë. Sugjerohet si për përdorim të brendshëm, ashtu edhe për të jashtëm.

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Nëse bëhet fjalë për një sipërfaqe të re, kaloni një astar terpenitinë të "H" dhe më pas lyejeni me UN-MOULD, si bojë të përshtatshme plastike. Kur bëhet fjalë për sipërfaqe që kanë myk, fillimisht lajeni me pastruesin përkatës të UN-MOULD Cleas të "HROMODHOMI". Më pas kaloni një dorë nënshtrësë MONO-SMOKE. Kështu, sipërfaqja do të jetë përgatitur siç duhet, për përdorimin e bojës UN-MOULD, tërësisht e padëmshme për njeriun.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
12-16m2/lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	Thahet sipas sipërfaqeve nga 20 deri në 60min dhe sipas kushteve të tharrjes	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Mono-Smoke Astar terpenitinë



Magazinimi ne kove plastike 0.75Lt\*, 3Lt, 10Lt





### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë plastike e cilësisë së mirë për përdorim të brendshëm, me mbulueshmëri të madhe dhe bardhësi përshtypjëlënëse. Përdoret atje ku nuk do të ketë larje të shpeshta të sipërfaqes së lyster me bojë.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pasi ta pastroni mirë sipërfaqen që dëshironi të lyeni, kaloni një dorë VELVET-LATEX të holluar me ujë deri në 15%. Në vazhdim, pas një ose dy orë kaloni dorën tjetër, duke e holluar 5 deri 10% me ujë. Në sipërfaqe metalike, sipërfaqet duhet të lyhen patjetër me antiruxho (kundër ndryshkut). Kushte të papërshtatshme gjatë kyerjes mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësisë së ngjyrës përfundimtare.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-10m <sup>2</sup> /lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Astar boje plastike Materiali i parë



Magazinimi ne kove plastike  
3Lt, 10Lt



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë tavanesh, tejet e bardhë për përdorim të brendshëm. Punohet dhe shtrihet lehtë pa lënë gjurmë "ruli". Rezistente ndaj gërvishtjeve të forta dhe mbulon të gjitha llojet e sipërfaqeve me dy duar.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Boja ΔΠΟΧΡΩΜΑ kalohet me dy duar. Në dorën e parë holloneni bojën me ujë deri në 15%, kurse në dorën e dytë 5 deri 10%. Nëse do të përdorni ΔΠΟΧΡΩΜΑ, duhet të keni parasysh se kur thahet, ngjyra e saj hapet.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
4-6m <sup>2</sup> /lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20min. sipas kushteve	E bardhë dhe me bazë (P) në nuancat e hapura	Astar boje plastike Materiali i parë



Magazinimi ne kove plastike  
3Lt, 10Lt


**Përzgjedhja e ngjyrave që do të përdoren në një ambient të brendshëm, ka lidhje direkte me kriteret estetike të të interesuarit, karakteristikat e ambientit, por edhe mobilimin.**




dhoma për fëmijë

## ngjyra & dekorim

Në sallon ngjyrat e nxehta, por edhe kombinimet e tyre, japin një sens harmonie në ambient. Kjo mund të arrihet me përdorimin e ngjyrës në të gjithë hapësirën, ose në një mur.



Sallone



Dhoma Gjumi

Në dhomat e fëmijëve mund të përdoren ngjyra dhe kombinime të theksuara, sepse fëmijëve iu përqejnë këto ngjyra, duke inkuadruar edhe figura të ndryshme, apo skena fëmimore mbi muret e dhomës.

Kuzhina



Përgjithësisht dhomat e gjumit luhen në ngjyra pastel dhe nuanca të ngrohta, që krijojnë mjedis çlodhës, si p.sh.: ngjyrë livando, e kaltër ose jeshile.

Kërkesat përsa i përket ambientit të kuzhinës, veçanërisht kur shrihet si ambient me salloni, janë të mëdha. Në këtë rast nuk ka kufizime, por mjafton që ngjyra që do të përzgjidhet të jetë e cilësisë së mirë dhe të lahet lehtësisht.



LIFE ACRYL



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë çimentoje, e cilësisë së përsosur 100%, për lyerjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të jashtme. Ka rezistencë të lartë dhe mbulueshmëri të madhe, si dhe punohet mirë, gjë që e bën të njohur tek profesionistët dhe jo vetëm. Ideale për beton, tulla, suva, me rezistencë të lartë ndaj elementëve alkaiikë të betonit.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra dhe të thata, pa pluhur dhe vajra, dhe të jenë kaluar me astar Water Undercoat ose me Astar Terpentine të "HROMODHOMI". Përziëni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Produkti punohet në dy ose tre shtresëzime (duar), që duhet të bëhen 4 orë larg njëra-tjetrës. Produkti përfiton të gjitha cilësitë e tij mekanike të rezistencës, pas 20-30 ditësh.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
10-15m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	Sipërfaqësisht në 1 orë. Përsëritet pas 4 orësh.	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar Terpinë Water Undercoat



STEP ACRYL 100%



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Përzgjedhja më e mirë e mundshme për lyerje dhe mbrojtje të sipërfaqeve të jashtme. Përbërja e saj e veçantë me 100% akrelin-strenit e bëjnë të jetë e patjetërsueshme ndaj faktorëve të jashtëm. E përshtatshme për beton, suva, tulla, novopan etj. Ka rezistencë të lartë ndaj elementëve alkaiikë të betonit.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përziëni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pasi e keni pastruar, keni kaluar dhe astarin në sipërfaqe që dëshironi të lëni, kaloni dorën e parë të STEP ACRYL të holluar deri në 15% me ujë. Në vazhdim, pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% me ujë. Kjo bojë është e pacënueshme nga ngricat, igrasia dhe rrezatimi diellor.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
10-15m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-25min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar Terpinë Water Undercoat



BOLERO ACRYL



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

BOLERO ACRYL është materiali më i mirë për lyerjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të jashtme. Ka rezistencë të madhe në mjedisin alkaiik të betonit. Përshtatshmëria e tij e madhe në të gjitha llojet e betonit, suvave etj, e bëjnë bojën ideale, për përdorime të jashtme.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përziëni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pastroni sipërfaqen që dëshironi të lëni. Kaloni dorën e parë të BOLERO ACRYL të holluar deri në 15% me ujë. Pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% me ujë. Në sipërfaqe të vështira (si: mure veriore, zona bregdetare etj.), sugjerhet të kalohet fillimisht një astar akrilik terpinë, të "HROMODHOMI".

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-12m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-40min. sipas kushteve	E bardhë dhe në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar boje plastike Water Undercoat Material i parë



COVER ACRYL



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë e fortë që u lejon të mbulonit të gjitha sipërfaqet e ekspozuara ndaj faktorëve klimaterikë të jashtëm. Baza e saj akrilike, garanton rezistencë shumëvjeçare. Tejkalon të gjithë parametrat e cilësisë më të lartë të bojërave plastike në kushte të vështira klimaterike, sipas matjeve të bëra nga ELOT 788.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përziëni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Në sipërfaqe të pastruar dhe të kaluar me astar, kaloni dorën e parë të COVER ACRYL të holluar deri në 15% me ujë. Pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% me ujë. Në sipërfaqe të vështira (si: mure veriore, zona bregdetare etj.), sugjerhet të kalohet fillimisht një astar akrilik terpinë, të "H". Kushte të vështira gjatë lyerjes, mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësive në ngjyrë.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-12m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	25-30min. sipas kushteve	Disponohet në të bardhë, gri dhe ngjyrë tulle. Gjithashtu në tre baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar Terpinë Water Undercoat



Magazinimi ne kove plastike  
0.75Lt, 3Lt, 9Lt, 10Lt



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë akrilike e cilësisë së mirë për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm. Disponon mbulueshmëri të madhe dhe bardhësi përshtypjëlënëse. Përbërja e saj akrilike e bën të jetë autentike kundrejt elementëve alkaikë të çimentos.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Në sipërfaqe të pastruar dhe të kaluar me astar, kaloni dorën e parë të COVER ACRYL të holluar deri në 15% me ujë. Pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% me ujë. Në sipërfaqe metalike, duhet të paraprijë lyerja me likuidin anti-ndryshk.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-12m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	1-2 orë sipas kushteve	E bardhë dhe në dy baza të sistemit të bojërave POLIKROMIKE	Astar Terpetinë Water Undercoat



Magazinimi ne kove plastike  
3Lt, 9Lt, 10Lt



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë akrilike e cilësisë së mirë për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm. Disponon mbulueshmëri të madhe dhe bardhësi përshtypjëlënëse. Përbërja e saj akrilike e bën të jetë autentike kundrejt elementëve alkaikë të çimentos.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Në sipërfaqe të pastruar dhe të kaluar me astar, kaloni dorën e parë të VELVET ACRYL të holluar deri në 15% me ujë. Pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% me ujë. Është e pacënueshme nga ngricat, igrasia dhe rrezatimi diellor. Për këtë mund të japim 12 vjet garanci rezistence shumë të mirë, ndaj të gjitha kushteve.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-12m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-25min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Astar Terpetinë Water Undercoat



Magazinimi ne kove plastike  
3Lt, 9Lt,



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë akrilike silikone për përdorim të jashtëm, e përshtatshme për lyerje mbi çimento dhe suva. Dallohet për rezistencë në kushte të vështika klimaterike (igrasi, shi, ndotje atmosferike). Nuk lejon lagështinë e jashtme dhe igrasinë të depërtojnë në mur. Por lejon që igrasia e murit të dalë në formë avulli. "Vetpastrohet" nga ndotjet atmosferike me ujin e shiut. Ideale për raste kur "vjell" boja, nga igrasia e brendshme.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Në sipërfaqe të pastruar dhe të kaluar me astar, kaloni dorën e parë të SILICON STEP ACRYL të holluar deri në 15% me ujë. Pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% me ujë. Është e pacënueshme nga ngricat, igrasia dhe rrezatimi diellor.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
10-15m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 5-10% ujë	20-25min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Silicon Undercoat



Magazinimi ne kove plastike  
0.75 lt\* 3Lt, 10Lt,



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Bojë Step Acryl Swhite Spirit është materiali më ideal për lyerje dhe mbrojtje të sipërfaqeve të jashtme. Përbërja e saj e veçantë e shpërbërësit e bën të ketë jetëgjatësi, rezistencë në kushtet më të vështira klimatike dhe kundrejt ndotjes atmosferike. Përdoret mbi beton, suva, tulla, novpan etj. Ka mbulueshmëri të madhe dhe ngjitje të fortë.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Në sipërfaqe të pastruar dhe të kaluar me astar, kaloni dorën e parë të STEP ACRYL W.S. të holluar deri në 15% White Spirit. Pas 1 ose 2 orësh kaloni dorën e dytë duke e holluar 5-10% W.S. Boja STEP ACRYL W:S: për shkak të përbërjes së saj, përveç sipërfaqeve të jashtme, është e përshtatshme për t'u përdorur edhe për lyerje dyshemesh betoni.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
10-15m <sup>2</sup> /lt boje për shtresë	Dora e parë 15% White Spirit Dora e dytë 5-10% White Spirit	Thahet për rilyerje pas 45-60min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Astar Terpetinë



Magazinimi ne kove Metalike  
0.75 lt\* 4kg, 15kg



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Boja RELIEF është ndërmarrja akrilike relevike, me cilësi të veçanta rezistence dhe bukurie. Përbërja e saj, e bën atë, që të jetë bojë e përshtatshme për sipërfaqe të jashtme me efekte afatgjata mbrojtjeje, nga kushtet e vështira klimaterike, nga ndotja atmosferike dhe rrezatimi diellor.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Boja RELIEF kalohet në dy duar. Në dorën e parë hollimi bëhet 5% ujë dhe pasi thahet mirë, i kalohet dora e dytë e paholluar. Për të arritur rezultatin e dëshiruar në "sarge", dora e dytë duhet lyer me rul RELIEF. Mund ta zvogëlojmë, apo zmadhojmë gjurmëlënien, në vartësi të përdorimit të rulit.



Magazinimi në kove plastike  
5kg, 10kg.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
1m <sup>2</sup> /kg ngjyre për shtresë	Dora e parë 5% ujë Dora e dytë e paholluar	15-30min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Astar Terpetinë Water Undercoat



## BOJRA AKRELIKE

PER PERDORIM TE JASHEM





**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

MONO-STOP është një tharrës izolues për mbrojtjen e sipërfaqeve të vështira. Izolon dhe than taraca, mure etj. Shtrihet dhe mbi izolantë pise dhe asfalti, si dhe në mure themel betoni. Për shkak të përbërjes së tij akrilike, ka rezistencë të madhe, jo vetëm si termoizolues për rrezatimin diellor, por edhe si tharrës igrasie. Elasticiteti i tij është matur në 593%

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pastroni shumë mirë sipërfaqen që do të lyhet. Më pas kalojini një dorë Astar Terpetinë të "HROMODHOMI", të holluar me 50% White Spirit. Ditën tjetër lyejeni sërish me MONO-STOP të holluar 10% me ujë. E njëjta gjë përsëritet edhe një ditë më pas (nëse dëshironi), por këtë herë pa e holluar. Për raste të vështira dhe problematike, sugjerohet dhe një lyerje më shumë. KONDICIONE: Duhet që, të paktën për 24 orë pas lyerjes, të mos laget.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
1,5m <sup>2</sup> /lt izolanti (për sipërfaqe horizontale) 3m <sup>2</sup> /lt izolanti (për sipërfaqe vertikale)	Dora e parë 10% ujë Dora e dytë e paholluar	30-40min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë dhe ngjyrë tulle	Astar Terpetinë



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt\* , 3Lt , 10Lt

**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

MONO-FLEX është një izolues akrilik për sipërfaqe vertikale, me rezistencë dhe mbulueshmëri të madhe, që njëkohësisht lyen dhe izolon. Përbërja e produktit e bën atë ideal për kushte të vështira klimaterike, pa probleme plasaritjesh, apo çarjesh. Ngjitet shumë mirë mbi beton, në blloqe çimentoje, mbi suva, në tullë etj. Paraqet rezistencë të madhe kundrejt elementëve alkalikë të çimentos dhe kundrejt elementëve të ndrotjes atmosferike.

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 40° celcius dhe kur igrasia është më e lartë se 80%. Pastrojmë shumë mirë sipërfaqen dhe e lyejmë me Astar Terpetinë të "HROMODHOMI" të holluar me 100% White Spirit. Më pas kaloni një dorë MONO-FLEX të holluar me 15% me ujë. Pas 4-6 orë mund të kaloni dorën e dytë të holluar me 10% ujë.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
8-10m <sup>2</sup> /lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 10% ujë	20-25min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë dhe në tre baza	Astar Terpetinë Water Undercoat



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt\* , 3Lt , 10Lt

**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

MONO-STOP 2K është një hidroizolues elastik i përhapshëm, një llaç 2 përbërësish. Përbëhet nga një pastë akrilike (përbërësi A) dhe çimento të bardhë e cilësisë së lartë EN-42,5 (përbërësi B). Përdoret për izolimin e sipërfaqeve të betonit, suvasë, tullës, pllaka çimentoje, mozaikëve, gipsosanidhave, drurit, metalit etj. Është ideal për punime ku kërkohet elasticiteti i lartë dhe ngjitje e mirë e shtresës hidroizoluese. I përshtatshëm për hidroizolim të sipërfaqeve që janë nën efekte fibravioni dhe tronditjeje.

**UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI**

Pastrojmë shumë mirë sipërfaqen para izolimit. Më pas kalojmë një Astar Terpetinë të "HROMODHOMI" të holluar me 50% White Spirit ose Astar Kuarc të "H" të holluar me 30% ujë. Hedhim në kovën prej 15kg (Përbërësi A) 10 kg çimento të bardhë (Përbërësi B). E përziejim në mikser, me xhiro të ngadalta (200 deri 400 në minutë). Mos e përdorni në temperatura nën 6° celcius dhe mbi 35°. Ditën tjetër pasi keni kaluar astarin, shtroni MONO-STOP 2K dhe nëse është e nevojshme, hollojeni deri në 5% me ujë. Të njëjtën gjë përsërisni edhe ditën tjetër. Për raste të vështira dhe problematike, sugjerohet edhe një shtrim tjetër. KONDICIONE: Duhet të mos laget, pas shtrimit, për të paktën 24 orë. Produkti përfiton të gjitha

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
3,5Kg/m <sup>2</sup> izolanti përbërje e gatshme	Pa hollim	30-40min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Astar Kuarc Astar Terpetinë

**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME**

THERMONO FLEX është një akrilik i cilësisë më të lartë, termoizolues i veçantë dhe bojë antimyk, për mure të jashtëme dhe taraca. Është "elastome", ruan elasticitetin në temperaturat që merr, që prej -20° celcius deri në +80° celcius. Mbulon në mënyrë të përsosur plasaritje të vogla në sipërfaqe, duke ofruar kështu hidroizolim të shkëlqyer, në mure të jashtëme, nga igrasia. Kokrizat e vogla termoizoluese që mbart, i japin veçori termoizoluese, që kontribuojnë në kursimin e energjisë gjatë dimrit dhe verës. Punohet mbi çdo lloj sipërfaqeje të vjetër apo të re.

Krijon një membranë të padepërtueshme dhe elastike, tejet të durueshme, kundrejt kushteve të jashtme klimaterike. Ofron një sipërfaqe të përkryer mat. THERMONOFLEX-i është një ngjyrë e ftohtë dhe karakterizohet nga fuqi e lartë pasqyrimi, të rrezatimit diellor. THERMONO FLEX mund të përdoret veçmas, ose si pjesë e sistemit 100% ACRYL THERMONOSYSTEM si dorë e fundit, duke shërbyer si ndihmës në të gjithë sistemin e termoizolimit.

Për udhëzime të aplikimit ju lutemi t'i referoheni te dhenave zbatuese te MONO FLEX.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	ASTARET E PREFERUAR
6-8m <sup>2</sup> /lt për shtresë	Dora e parë 15% ujë Dora e dytë 10% ujë	20-25min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë dhe në tre baza	Water Undercoat Astar Terpetinë



Magazinimi në kove plastike  
0.75Lt\* , 3Lt , 10Lt

PRIMER



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Substrat i cilësisë së shkëlqyer, me veçori të theksuara kundër ndryshkut, për përdorim industrial. Mbron të gjitha sipërfaqet metalike dhe i parapërgatit për lyerjen përfundimtare. Thahet shpejt dhe i reziston temperaturave të larta (deri në 100° celsius). Është i përshtatshëm për kangjella, trarë, dyer dhe çdo sipërfaqe të hekurit që ka të nevojshme mbrojtjen nga oksidimi.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celsius dhe mbi 40° celsius, si dhe në igrasi relative mbi 80%. Pasi pastroni sipërfaqen metaklike nga shenjat e ndryshkut, pluhuri dhe vajrat, kalojini një dorë PRIMER që thahet shpejt të holluar me 5 deri në 10% me nitro. Kur të thahet, fërkojeni me letër zmeril të hollë dhe më pas është gati për t'u lyer. Kushtet e vështira klimaterike gjatë punimeve, mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësisë së nuancës përfundimtare të ngjyrës.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	AMBALLAZHI (KUTIA)
10-12m2/lt për shtresë	Hollues White Spirit ose hollues nitro në raport 5-10%	E thatë për lyerje pas 10-15min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë gri, bezhë, të zeze, të bardhë dhe në nuancë ngjyrë tulle	Disponohet në kuti metalike 0,375lt*, 0,750lt*, 2,5lt***, 9lt



AUTO PRIMER



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Substrat korife me cilësi të larta kundër ndryshkut, për bojëra makinash dhe për përdorim industrial. Mbron të gjitha sipërfaqet metalike dhe i parapërgatit për lyerjen përfundimtare. Thahet shpejt dhe i reziston temperaturave të larta (deri në 100° celsius). Është i përshtatshëm për sipërfaqe metalike makinash, si dhe për kangjella, trarë, dyer dhe çdo sipërfaqe të hekurit që ka të nevojshme mbrojtjen nga oksidimi.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celsius dhe mbi 40° celsius, si dhe në igrasi relative mbi 80%. Pasi pastroni sipërfaqen metalike nga shenjat e ndryshkut, pluhuri dhe vajrat, kalojini një dorë AUTO PRIMER që thahet shpejt, të holluar me 5 deri në 10% me nitro. Kur të thahet, fërkojeni me letër zmeril të hollë dhe më pas, është gati për t'u lyer. Kushtet e vështira klimaterike gjatë punimeve, mund të shkaktojnë tjetërsim të cilësisë së nuancës përfundimtare të ngjyrës.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	AMBALLAZHI (KUTIA)
12-15m2/lt për shtresë	Hollues nitro në raport 5-10%	E thatë për lyerje pas 10-20min. sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë gri, bezhë dhe në nuancë ngjyrë tulle	Disponohet në kuti metalike 0,75lt*, 2,5lt***



ZINC PRIMER



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Substrat korife me cilësi të larta kundër ndryshkut. Mbron të gjitha sipërfaqet metalike dhe i parapërgatit për lyerjen përfundimtare. Mekanizmi i mbrojtjes bazohet në jone zinku fosforik. Aplikohet atje ku ju nevojitet mbrojtje absolute dhe rezistencë e lartë.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celsius dhe mbi 40° celsius, si dhe në igrasi relative mbi 80%. Pasi pastroni sipërfaqen metalike nga shenjat e ndryshkut, pluhuri dhe vajrat, kalojini një dorë ZINC-PRIMER të holluar me 5 deri në 10% me White Spirit. Kur të thahet fërkojeni me letër zmeril të hollë dhe më pas, është gati për t'u lyer. Kushtet e vështira klimaterike gjatë punimeve, mund të dëmtojnë cilësinë në shtrim.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	AMBALLAZHI (KUTIA)
12-15m2/lt për shtresë	Hollues White Spirit në raport 5-10%	Sipërfaqësisht në 1-2 orë. Në vartësi të kushteve dhe të trashësisë së shtresës së aplikuar	Disponohet në ngjyrë gri	Disponohet në kuti metalike 0,75lt*, 2,5lt***



CHASSIS COAT



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

"Sasikot" është llak me ngjyrë, për sipërfaqet metalike në sashitë e makinave. Punohet shumë lehtë, përhapet më së miri, jep shkëlqim dhe mbron nga ndryshkja. Është i lehtë në përdorim, ka mbulueshmëri të madhe dhe shtrirje të përsosur.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieri mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celsius dhe mbi 40° celsius, si dhe në igrasi relative mbi 80%. Aplikohet në sipërfaqe të pastruara mirë. Punohet me furçë, rul, ose pistolette. Hollohet me White Spirit ose me terpentinë.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	AMBALLAZHI (KUTIA)
12-14m2/lt për shtresë	Hollues White Spirit të "HROMODHOMI" në analogji 5-10%	E thatë për lyerje pas 1 orë	Disponohet në ngjyrë të zeze, gri, blu dhe qiparis	Disponohet në kuti metalike 0,75lt**, 2,5lt***





### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Substrat tërësisht i bardhë për mure dhe sipërfaqe druri të brendshme ose të jashtme. Punohet shumë lehtë, përhapet më së miri dhe ka aftësi mbulimi para lyerjes përfundimtare.

### UDHËZIME PËRDORIMI & ZBATIMI

Përzieni mirë para përdorimit dhe mos e përdorni në temperatura nën 6° celsius dhe mbi 40° celsius, si dhe në igrasi relative mbi 80%. Aplikohet në sipërfaqe të pastruara mirë dhe të fërkuara me letër zmeril. Thahet për 2-4 orë dhe mbulon 8-10m<sup>2</sup>/lt. Më pas fërkojeni me letër zmeril të hollë sipërfaqen dhe jeni të gatshëm për dorën e fundit me smalt.

SASIA	HOLLIMI	THARRJA	NUANCAT	AMBALLAZHI (KUTIA)
10-15m <sup>2</sup> /kg për shtresë	Hollues White Spirit në raport 5-10%	2-3 orë sipas kushteve	Disponohet në ngjyrë të bardhë	Disponohet në kuti metalike 0,75lt*, 2,5lt***



### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

